



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

Datë: 23.04.2025
Numër Protokolli: 2795/2025

A.nr.441/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.441/2025, të datës 10.03.2025, të parashtruar nga ankuesja F.B., kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.441/2025, e datës 10.03.2025, e parashtruar nga ankuesja F.B.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 21.02.2025 i Komisionit të Pranimit për rezultatet përfundimtare për pozitën “*Zyrtar Ligjorë*” në Prokurorin Themelore ne Prizren.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, F.B.(*tutje referuar ankuesja*), më datë 10.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1563/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.441/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 21.02.2025, të Komisionit të Pranimit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, lidhur me rezultatet përfundimtare të kandidatëve për pozitën *Zyrtar Ligjorë*” në Prokurorin Themelore ne Prizren, të shpallur sipas Konkursit publik me numër Nr.04/2024 të datës 19.12.2024, nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 28.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1563/2025 të parashtruar nga ankuesja më datë 10.03.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kopjen e letërnjoftimit të F.B. konkursin me Numër 04/2024 të datës 19.03.2024; njoftimin e datë 22.07.2024; kërkesën për përgjigje ne ankese të datës 21.03.2025; përgjigjen ne ankese të datës 28.03.2025;Kerkesne për aprovim

te datës 19.12.2024 dhe aprovimin; Vendimin e datës 09.01.2025 për themelimin komisionit te pranimit; Akt Emërimet e anëtarëve te Komisionit te Pranimit;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses është ***e pabazuar, sepse:***

Nga analizimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës, më datë 19.12.2024, ka shpallur Konkursin Nr.04/2024 për rekrutimin e 25 pozitave, duke përfshirë këtu edhe pozitën e punës “Zyrtar Ligjor” në kuadër të Prokurorisë Themelore ne Prizren, me afat për aplikimi nga data 19.12.2024 deri më datë 02.01.2025.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (28) kandidatë, ndërsa kriteret i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë (25) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila ka qenë pjesë e vlerësimit në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit.

Ndërsa, sipas Njoftimit të datës 21.02.2025, të Komisionit të Pranimit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ankuesja është renditur e dyta me gjithsejtë 86 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimit, pas kandidati fituese G.B i cili me gjithsejtë 87 pikë të përgjithshme është shpallur kandidat fituese për pozitën e punës “Zyrtar Ligjor” në kuadër të Prokurorisë Themelore ne Prizren

Ankuesja, kundër Njoftimit të datës 21.02.2025 mbi rezultatet përfundimtare të kandidatëve për procedurën përkatëse të rekrutimi, më datë 10.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar përmes shkeljeve të dispozitave ligjore, gjegjësisht e njëjta pretendon se nuk ishte vlerësuar drejte dhe kërkon te rishikohet testi me shkrim dhe kërkon sqarim pse nuk është pranuar ne këtë pozite dhe pretendon se ka kualifikime te mjaftueshëm për këtë pozite.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë*, kështu që, nisur nga ky referim ligjor rrjedhë së të punësuarit në administratën e Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore Këshilli Prokurorial me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e pranimit të nëpunësve civilë në këtë institucion gjegjësisht Këshilli Prokurorial i Kosovës, më datë 18.06.2024 ka nxjerr Rregulloren Nr. 03/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, ku sipas nenit 1 paragrafi 1, është përcaktuar se: *Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kriterëve, rregullave, themelimi i komisioneve, procedurave për rekrutimi, vlerësimin, pranimin, emërimin dhe vlerësimin e punës provuese për të punësuar në administratën e sistemit prokurorial në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.*

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit për pozitën Zyrtar Ligjor në kuadër të Prokurorisë Themelore të Prizrenit dhe si rrjedhojë Kolegji ka gjetur se si kriteret të përgjithshme për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: - *Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik dhe -Së paku një (1) vite përvojë pune profesionale.*

Andaj, Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, ju referuar legjislacionit në fuqi, gjegjësisht dispozitave ligjore të Rregullores Nr. 03/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, me theks të veçantë nenit 13 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. Kopjen/t e diplomës/ave të kërkuar/a me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, diploma e fituar jashtë vendit duhet të nostrifikohet apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim, të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.;* nenit 15 paragrafi 5, ku përcaktohet se: *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. Verifikimi paraprak, përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 5.2. Vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve...;* dhe se referuar kuadrit përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankueses se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar përmes parregullsive ngase e njëjta nuk është vlerësuar drejte në krahasim me kandidatin fituese është i pa bazuar, ngase nga analizimi i provave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë Kolegji ka gjetur se kandidati fituese në aplikacionin e punësimit ka bashkangjitur dokumentacion të mjaftueshëm dhe se i njëjti e plotëson kriterin e *përvojës së punës një (1) vjeçare profesionale* pas studimeve themelore, të përcaktuar me shpalljen e konkursit të datës 19.12.2024, ngase është fakt i pa kontestueshëm se i njëjti ka bashkangjitur Certifikatën e lëshuar më datë 27.03.2019 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, me të cilin dokument dëshmohet se i njëjti nga data 20.03.2018 deri me date 19.03.2019 ka përfunduar stazhin e praktikantit vullnetar pa pagese ne Prokurorinë Themelore ne Prizren. Ndërsa, sa i përket plotësimit të kriterit arsimor të kërkuar me shpalljen e konkursit përkatës, gjegjësisht *Diplomës se Fakultetit Juridik*, i njëjti se bashku me aplikacion ka bashkangjitur Diplomën me Nr.346 të datës 28.09.2017, të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit,, *Ukshin Hoti*”, përmes se cilës dëshmohet se i njëjti më datë 14.09.2017, ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Juridik, duke fituar titullin Bachelor ne Juridik.

Andaj, bazuar në të gjeturat dhe konstatimin e më sipërm se kandidatja fituese ka plotësuar kriteret e përgjithshme, Kolegji i Këshillit me qëllim të konstatimit se kandidatët e procedurës përkatëse të rekrutimit janë vlerësuar në mënyrë meritore dhe profesionale, fillimisht ka analizuar përbërjen e Komisionit Ad-hoc të Pranimit dhe se nga analizimi i provave të lëndës ka konstatuar së përbërja e Komisionit, i themeluar sipas Vendimit me shifër DPSKPK/Nr.06/2025 të datës 09.01.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, është në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 7 i Rregullores Nr. 02/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, i cili përcakton se: *Vlerësimi profesional i kandidatëve për emërimin në një pozita të kategorisë profesionale bëhet nga Komisioni i pranimit. 1. Komisioni i pranimit për kategorinë profesionale përbëhet nga pesë (5) anëtarë të rregullt dhe për secilën kategori të anëtarëve të komisionit caktohet një anëtar zëvendësues, në këtë përbërje: 2.1. Tre (3) punonjës të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilën zhvillohet konkurrimi, ku njëri nga ta caktohet kryetar i komisionit; 2.2. Një (1) përfaqësues nga NJMBNJ-ja dhe 2.3. Një (1) punonjës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse sipas pozitës për të cilën zhvillohet konkurrimi.*

Kolegji i Këshillit, tutje ka analizuar vlerësimin e kandidatëve në procedurën përkatëse të rekrutimit, dhe si rrjedhojë ka gjetur se hapi i parë i vlerësimit për kandidatët pjesëmarrës, gjegjësisht testi me shkrim, ku kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësisë dhe cilësitë e domosdoshme, është përpiluar në pajtim me kërkesat ligjore të nenit 17 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, ngase testi ka qenë i njëjti për gjithë kandidatët pjesëmarrës dhe ka përmbajtur gjithsejtë njëzetepesë (25) pyetje me

një përgjigje të saktë dhe një (1) ese, dhe se ankuesja nga kjo fazë e vlerësimit nga 70 pikët maksimale ka arritur ti mbledhë gjithsejtë 60 pikë, rrjedhimisht nga pyetjet me një përgjigjeje te saktë ankuesja ka dhënë 23 pyetje te sakta duke arritur të grumbulloje 46 pikë ndërsa ne ese nga anëtarët e Komisionit të Pranimit nga secili anëtar është vlerësuar me piket përkatëse si ne vijim: (15,13,13,14,15) referuar nenit 18 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, ku përcaktohet se: 2. *Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë;* dhe e njëjta sikurse edhe kandidati fitues me gjithsejtë 62.4 pikë të arritura gjegjësisht i njëjti nga pyetjet me një përgjigjeje te saktë ka dhënë 25 pyetje te sakta duke arritur te grumbulloje 50 pikë ndërsa në ese nga anëtarët e Komisionit të Pranimit nga secili anëtar është vlerësuar me pikët përkatëse si në vijim: (12,13,12,12,13) andaj si ankuesja ashtu edhe kandidati fitues nga kjo fazë vlerësimi kanë kaluar në fazën përfundimtare të vlerësimit atë të intervistës me gojë.

Tutje, Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për procedurën përkatëse të rekrutimit, atë të intervistës me gojë në të cilën vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testit me shkrim, dhe se nga analizimi i së cilës ka gjetur se ankuesja nga Komisioni i Pranimit është vlerësuar me gjithsejtë 26 pikë nga 30 pikët maksimale, respektivisht sipas formularëve te vlerësimeve individuale të anëtarëve veç e veç për kandidatin ne interviste me gojë ankuesja është vlerësuar nga secili anëtar me piket përkatëse si ne vijim: (26,26,26,26,26), ndërsa kandidati fitues është vlerësuar me gjithsejtë 24.6 pikë të përgjithshme nga kjo fazë rekrutimi, thënë më konkretisht ankuesja është vlerësuar në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 18 paragrafi 3, i Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, ku përcaktohet se: 3.*Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4.Në intervistë vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit, i cili përgatit apo përzgjedh pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/zgjedhën në ditën e zhvillimit të intervistës. 6.Intervista për të gjitha kategoritë përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin, me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7.Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 8.Në intervistë, kandidati mund të marrë më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 9.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon:9.1. Deri në tre (3) pikë për arsimimin.9.2. Deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë. 9.3.Deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 10.Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve”,* andaj sa i përket pretendimit ankimor te ankueses për parregullsi gjatë zhvillimit të procedurës përkatëse të rekrutimit gjegjësisht fazës se intervistës me goje , Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankueses është i paqëndrueshëm ngase në bazë të shkresave të dërguara nga organi i punësimit konkretisht formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për ankuesen dhe kandidatin fitues në intervistë të datës 20.02.2025, ka konstatuar se pesë pyetjet e intervistës të parashtruara nga Komisioni i Pranimit kanë qenë të njëjta sikurse për ankuesen ashtu edhe për kandidatin fitues, ndërsa referuar dispozitave përkatëse ligjore të sapo theksuara konkretisht paragrafit 6 të nenit 18 te rregullores se lartpërmendur përcaktohet se anëtarët e Komisionit të Pranimit përveç pyetjeve, mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin, me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore andaj kandidatët nga kjo fazë rekrutimi vlerësohen për vet përgjigjet e dhëna në raport me pyetjet përkatëse, ashtu që për rrjedhoje ankuesja me asnjë provë nuk ka mundur të mbështet pretendimin se komisioni në rastin konkret nuk ka bërë vlerësim real dhe objektiv.

Ashtu, që për sa më sipër Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses të ngritura në ankese, janë të pa bazuara, ngase procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me kriteret e përcaktuara sipas aktit ligjor të lartë theksuar të organit përkatës të punësimit, dhe se ankuesja sikurse edhe kandidati fitues kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e rekrutimit, mirëpo ankuesja ka arritur

ti mbledhë gjithsejtë 86 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi, ashtu që me një diferencë prej 1 pikëve është renditur e dyta, pas kandidatit fitues G.B i cili ka arritur gjithsejtë 87 pikë të arritura, dhe si rrjedhojë i njëjti ka fituar të drejtën për emërim për pozitën *Zyrtar Ligjor*, pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 19 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, ku përcaktohet se: *1.Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të fituara në secilin hap të vlerësimit. 2.Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% pikësh totale që e përcjell tek NTMNJ-ja, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e marra në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat. 3.Lista publikohet në SIMBNJ (kur e njëjta të jetë funksionale), në uebfaqen e institucionit dhe në mjete të tjera të përshtatshme për informim.*

Andaj, duke u bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni i Pranimit AD-Hoc dhe Sektori i Burimeve Njerëzore në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e zhvillimit të procedurës përkatëse të rekrutimit, dhe rrjedhimisht shpalljen e Njoftimit të datës 21.02.2025 për rezultatet përfundimtare për pozitën *Zyrtar Ligjor* në Prokurorin Themelore në Prizren, ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plot gjendjen faktike si dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi i datës 21.02.2025 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve, për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor* në Prokurorin Themelore në Prizren, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.441/2025

Ylber FETAHAJ

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.B.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.